REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare Nr.15-400-60375 të datës 14.12.2020 duke u bazuar në Marrëveshjen së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

VENDIM
PËR EKZEKUTIMIN E PAGESËS DHE TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

I.OBLIGOHET, Drejtorati për Buxhet dhe Financa të bëjë ekzekutimin e pagesës në shumë prej **7,800.00** (shtatë mijë e tetëqind euro) konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare Nr.15-400-60375 të datës 14.12.2020 dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020 për zbatimin e Projektit **"Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës** i financuar nga Donatori BfdW nga Gjermania dhe zbatuar nga IADK që shtrihet në komunat Vushtrri, Skenderaj, Lipjan, Shtime, Viti dhe Kamenicë.
II. Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural mban përgjegjësinë ,do të kujdeset dhe do të kërkoj nga Organizata IADK raport përfundimtar dhe dëshmi për zhvillimin dhe përfundimin e aktiviteteve të parapara konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020.
III. Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet –transferohet në xhirollogarinë bankare të IADK-së nr. 2027000021712884 në TEB Bankë, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2021.
IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti i dërgohet për zbatim Drejtoratit për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 320-60242
Lipjan, më 15.02.2021

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti